


TaxNews

August 2025
Gusht 2025



Deloitte.

Sektori i Turizmit - Ndryshime Thelbësore dhe Detyrime të Reja për Operatorët Turistikë

I. Deklarimi i kapaciteteve shfrytëzuese të strukturave akomoduese

Të gjithë operatorët e strukturave akomoduese në kategoritë hotel, resort, strukturë akomoduese e trashëgimisë kulturore, hotel i shpërndarë, motel, fjetje dhe mëngjes (B&B), bujtinë, bllok apartamentesh, do të duhet të përmbushin detyrimet e reja ligjore që rrjedhin nga Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 160, datë 12.03.2025 "Për përcaktimin e periudhës së shfrytëzimit dhe të nivelit minimal të kapacitetit të shfrytëzimit të strukturave akomoduese" (tekstin e plotë të VKM e gjeni në këtë [link](#)). Ky vendim shënon një risi të rëndësishme në mënyrën se si monitorohet dhe vlerësohet aktiviteti në sektorin e turizmit.

Më poshtë do të gjeni të përmbledhura disa parashikime të VKM-së lidhur me deklarin e kapacitetit të strukturave akomoduese dhe nivelit të shfrytëzimit të tyre.

Periudha dhe niveli minimal i shfrytëzimit të strukturave akomoduese

Periudha e shfrytëzimit dhe niveli minimal i shfrytëzimit të strukturave akomoduese ndahet në dy sezona, konkretisht:

- 1 maj deri në 30 shtator, për të cilin niveli minimal i shfrytëzimit është 65% e kapacitetit të strukturës akomoduese; dhe
- 1 tetor deri në 30 prill, për të cilin niveli minimal i shfrytëzimit është 30% e kapacitetit të strukturës akomoduese.

Operatorët mund të zgjedhin midis: (i) Deklarimit bazuar në nivelin minimal si më lart; ose (ii) Deklarimit sipas parashikimit të tyre.

Detyrimi për deklarim të kapacitetit të strukturave akomoduese dhe nivelit të shfrytëzimit të tyre

Deklarimi mund të dërgohet në formë shkresore pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, ose në mënyrë elektronike në adresën e emailit:

Ministria.MTM@turizmi.gov.al sipas formateve të përcaktuara në anekset e VKM.

Afatet për kryerjen e deklaramit

Për vitin 2025 deklarimi duhet të kryhej brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e VKM-së, pra brenda datës 12 prill 2025. Ndërsa për vitin 2026 dhe në vijim, deklaramet duhet të kryhen brenda muajit janar të çdo viti. Kështu, për vitin 2026, deklaramet duhet të kryhen brenda 31 janarit 2026.

Impakti tatimor dhe rëndësia e deklaramit të saktë

Deklarimi i saktë i kapaciteteve dhe nivelit të shfrytëzimit është thelbësor pasi administrata tatimore do të përdorë këto të dhëna për të vlerësuar nëse të ardhurat e deklaruara më pas gjatë vitit janë në përputhje me kapacitetin dhe nivelin e shfrytëzimit të paradeklaruar nga struktura akomoduese. Administrata tatimore do të kryejë kontrolle të kryqëzuara duke përdorur burime të ndryshme informacioni,

përfshirë platformat online të rezervimeve, si Booking.com, Airbnb, Agoda, etj. Në rast mospërputhjesh të konsiderueshme, administrata tatimore mund të zbatojë metoda alternative vlerësimi dhe mund të llogarisë detyrime tatimore shtesë për strukturat akomoduese.

II. Punonjësit e huaj në sektorin e turizmit: detyrime dhe përgjegjësi

Sektori i turizmit në Shqipëri po tërheq gjithnjë e më shumë profesionistë të huaj. Kjo sjell përfitime në cilësinë e shërbimit, por edhe detyrime specifike për operatorët.

Hyrja, qëndrimi dhe punësimi i të huajve, në varësi të shtetësisë dhe kohëzgjatjes të punësimit, është subjekt i kërkesave ligjore të parashikuara në legjislacionin për të huajt.

Pajisja me leje unike për motive punësimi

Punonjësit e huaj që synojnë të punësohen në Shqipëri duhet të pajisen me leje unike për motive punësimi (njëkohësisht e vlefshme për qëndrimin dhe punësimin). Aplikimi mund të bëhet nga shtetasi i huaj ose punëdhënësi i tij, fillimisht në platformën e-albania dhe më pas, pranë drejtorisë rajonale të migracionit në Shqipëri që mbulon territorin ku i huaji do të punojë.

Përpara miratimit të lejes unike, shtetasit që kanë nevojë të pajisen me vizë për në Republikën e Shqipërisë, duhet të pajisen me vizë punësimi (të tipit D) pranë ambasadës apo konsullatës përkatëse shqiptare në vendin e tyre të rezidencës. Regjimi i vizave për shtetasit e huaj mund të konsultohet [këtu](#).

Mosrespektimi i detyrimeve dhe përgjegjësisë të mësipërme mund të sjellë dënime me gjobë, si për punëdhënësit, ashtu edhe për punonjësit e huaj.

Përfshirja e punonjësve të huaj në listëpagesën e operatorit dhe pagesat e kontributeve dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi

Çdo punonjës i huaj duhet të regjistrohet në organet tatimore 24 orë përpara fillimit të punës.

Operatori si punëdhënësi detyrohet të përlllogarisë, deklarojë, mbajë dhe paguajë pranë administratës tatimore kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat e punësimit brenda afateve ligjore.

Mosrespektimi i këtyre detyrimeve mund të sjellë implikime tatimore, përfshirë penalitete dhe kamatëvonesa.

III. Pagat indikative në sektorin e turizmit

Së fundmi, administrata tatimore ka publikuar listën e pagave indikative për sektorin e turizmit ([kliko këtu](#)). Kjo nismë synon të adresojë çështjen e nëndeklarimit të pagave dhe të inkurajojë deklarimin e pagave reale.

Pagat indikative janë përcaktuar duke u bazuar në të dhënat e tregut të punës për pozicione të ngjashme. Në përcaktimin e tyre janë marrë parasysh gjithashtu kualifikimet e kërkuara për çdo pozicion.

Impakti tatimor dhe rëndësia e deklarimit të saktë

Pagat nën nivelin indikativ mund të tërheqin vëmendjen e administratës tatimore, e cila mund të kërkojë justifikime për pagat që devijojnë ndjeshëm. Për bizneset me devijime të konsiderueshme rreziku i kontroleve të zgjeruara tatimore është më i lartë.

Në këto kushte, ne sugjerojmë të rishikoni me kujdes nivelet aktuale të pagave të punonjësve tuaj dhe të merrni masat e nevojshme në kohë.

IV. Faturimi dhe TVSH-ja e zbatueshme në sektorin e turizmit

Gjithashtu, rëndësi të veçantë ka edhe zbatimi korrekt i legjislacionit për fiskalizimin dhe TVSH-në në sektorin e turizmit. Kështu, ka parashikime specifike të cilat lidhen me llojet e faturave (si faturat porosi, faturat përmbledhëse, faturat për parapagime etj.), diversitetin e shërbimeve të ofruara dhe kohën/periudhat e shërbimit përkundrejt kohës/periudhave të faturimit.

Për këtë qëllim, administrata tatimore, përmes disa njoftimeve (kliko [këtu](#) dhe [këtu](#)), ka dhënë disa udhëzime kyçe që lidhen me përdorimin e emërimit të saktë për shërbimin/mallin në fatura, ndarjen e qartë të shërbimeve në fatura, zbatimin e normës korrekte të TVSH-së sipas llojit të shërbimit (6% ose 20%), ndarjen e komponentëve të paketave all-inclusive duke zbatuar normën korrekte të TVSH-së, etj.

V. Pagesat për platformat online si dhe për publicitetin në mediat sociale

Prej kohësh tanimë, administrata tatimore ka patur fokus të veçantë dhe të shtuar ndaj operatorëve turistikë të cilët përdorin platformat online si Booking.com, Airbnb, Agoda dhe mediat sociale si Instagram, Facebook, TikTok për paraqitjen dhe publicitetin e strukturave të tyre akomoduese.

Operatorët turistikë kanë detyrimin të dokumentojnë shpenzimet për komisionet e paguara ndaj këtyre platformave përmes autofaturash të lëshuara nën skemën reverse-charge të TVSH-së apo vetëfaturimit. Komisionet e paguara këtyre platformave gjithashtu janë objekt i tatimit të mbajtur në burim në masën 15%, përveç rasteve kur ekziston një marrëveshje për shmangien e taksimit të dyfishtë me shtetin ku platforma ka rezidencën fiskale, dhe për të cilën operatori turistik ndjek procedurën përkatëse për zbatimin e dispozitave të Marrëveshjes në përputhje me Udhëzimin nr. 11, datë 23.07.2024 "Për zbatimin e marrëveshjeve për shmangien e tatimit të Dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal".

VI. Webinar nga Deloitte Albania për sektorin e turizmit

Për t'ju ardhur më tej në ndihmë me informacione e këshilla, Deloitte Albania ju fton në 16 shtator 2025 në një webinar pa pagesë lidhur me sektorin e turizmit.

Klikoni në këtë [link](#) dhe regjistrohuni për të rezervuar vendin tuaj tani.

Related Contacts

Blerina Memo

Tax Partner | Tax & Legal
Deloitte Albania sh.p.k

“Rruga e Kavajës”,
Ish parku i mallrave,
Kompleksi Delijorgji, Godina L, Kati 3
1001, Tirana, Albania
E-mail: bmemo@deloittece.com

Xheni Kakariqi

Director | Tax & Legal
Deloitte Albania sh.p.k

“Rruga e Kavajës”,
Ish parku i mallrave,
Kompleksi Delijorgji, Godina L, Kati 3
1001, Tirana, Albania
E-mail: xkakariqi@deloittece.com

Disclaimer:

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the “Deloitte Network”) are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 312,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.